



PORTA E REGJISTRIMIT TË BIZNESIT TUAJ

20

RAPORT VJETOR
Regjistri Tregtar



Përmbajtja

A.	HISTORIKU I KRIJIMIT	4
	A.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BUXHETI	5
B.	KORNIZA LIGJORE DHE FUNKSIONET E QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT	6
C.	SHËRBIMET QË OFRON QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT	7
	C.1 REGJISTRI TREGTAR DHE REGJISTRIMI	7
	C.1.1 Regjistrimi	7
	C.1.2 Shërbimet funksionale	9
	C.2 FORMULARËT E APLIKIMIT SIPAS FORMËS LIGJORE:	10
	C.3 SHËRBIME TË REJA PËR PUBLIKUN	11
	C.3.1 Aplikimi online	11
	C.3.2 Përmirësimi i imazhit të institucionit të QKR-së	11
	C.3.3 Buletini i njoftimeve zyrtare	11
	C.3.4 Kontrolli i statusit të aplikimit për regjistrim	11
	C.3.5 Nënshkrimi elektronik	11
	C.3.6 Kërko për emër të lirë	12
	C.3.7 Paketë informuese për regjistrimin e bizneseve të huaja	12
D.	ANEKSI I STATISTIKAVE	12
	TABELA NR. 1 SHËRBIMET PËR BIZNESIN	12
	TABELA NR. 2. REGJISTRIMET E REJA SIPAS QARKUT DHE QYTETEVE	13
	TABELA NR. 3 REGJISTRIMET E REJA SIPAS KOMBËSISË	14
	TABELA NR. 4 BIZNESET SIPAS FORMËS LIGJORE	14
	TABELA NR. 5 BIZNESE TË REJA SIPAS GJINISË SË ORTAKËVE APO ADMINISTRATORIT	15
	TABELA NR. 6 NUMRI I VIZITORËVE NË PORTALIN WWW.QKR.GOV.AL	15

FAKTE

33

sportelet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

720,000

klikime të faqes së web-it.

40%

më shumë regjistrime të reja në vitin 2014

51.71%

e veprimeve kryhen në sportelet e Tiranës dhe 48.29% në qytetet e tjera

29.3%

është rritja e biznesit me pronësi të huaj krahasuar me vitin 2013

42%

më shumë regjistrime të degëve të shoqërive të huaja

238,512

çështje në vit procesohen nga QKR-ja

Afërsisht **900**

çështje në ditë procesohen nga nëpunësit tanë

24

orë për marrjen e përgjigjes

100

lekë për çdo aplikim

0

lekë për aplikimet online

7,620

shkresa të trajtuara më shumë në vitin 2014

116%

vizitorë më shumë të portalit

57%

janë rritur bizneset në pronësi të femrave

125

punonjës

5,000

klikime në ditë

32.5%

më shumë shërbim për bizneset

34%

më shumë bilance të depozituara

10

sportelet ofrojnë shërbimin edhe për licencimin

13.2%

është rritja e biznesit me pronësi shqiptare - e huaj

24%

e bilanceve janë depozituar nëpërmjet deklarimit elektronik

47.4%

e regjistrimeve të reja janë të formës person fizik

11.6%

është pjesëmarrja e femrave si administratore apo pronare në një biznes. (Për regjistrimet e reja)

38.41%

e regjistrimeve të reja kanë zgjedhur të merren me aktivitetin: tregtia, riparimi i automobilitave dhe artikujve shtëpiakë

A. Historiku i krijimit

Qendra Kombëtare e Regjistrimit është krijuar në bazë të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si një institucion i ri publik në nivel qendror.

Reforma e regjistrimit të biznesit:


- » fragmentar të regjistrimit të bizneseve;
- » të ekonomisë informale;
- » në regjistrimin e bizneseve;
- » e bizneseve dhe sistemit gjyqësor;
- » nëpërmjet mbledhjes së taksave;

QKR-ja është institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri dhe shërben si sportel me një ndalesë ku kryhen të gjitha proceset e regjistrimit të biznesit, duke përfshirë edhe regjistrimin për efekt të taksave në nivel kombëtar dhe vendor, sigurimin shëndetësor e shoqëror dhe inspektoratin e punës. QKR-ja e zhvillon aktivitetin e saj në 33 sportele në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në të cilat shërbejnë 75 punonjës me detyra dhe përshkrime pune të njëjta me ato të zyrës qendrore. Sportelet pritëse të biznesit në rrethe janë të vendosura pranë Bashkive dhe Komunave, si dhe në Dhomat e Tregtisë. Të gjitha aplikimet e kryera nga biznesi procesohen nga struktura e regjistrimit e vendosur në zyrën qendrore në Tiranë.

QKR-ja ofron një shërbim të unifikuar për aplikimet e regjistrimit dhe licencimit. Sportelet e QKR-së në qytetet kryesore shërbejnë edhe si sportele pritëse për aplikimet për licencim (*shërbejnë edhe për QKL-në*). Më konkretisht, këto sportele janë në qytetet: Elbasan, Berat, Durrës (*në bashki dhe Dhomën e Tregtisë*), Peshkopi, Fier, Gjirokastrë, Shkodër, Vlorë, Korçë.

QKR-ja funksionon në bazë të një sistemi elektronik të integruar të dhënash që realizon lidhjen ndërmjet sporteleve të shërbimit në rrethe me zyrën qendrore të QKR-së në Tiranë. Sistemi i regjistrimit u krijon mundësinë bizneseve të regjistrohen brenda 24 orëve dhe vetëm me anë të një formulari aplikimi, që kushton vetëm 100 lekë.

Qëllimi i punës së QKR-së është të ofrojë një shërbim sa më cilësor, të krijojë një kulturë administrative të biznesi etj. Me shërbimet që ky institucion ofron është arritur të plotësohen natyrshëm kërkesat e subjekteve tregtare. Tashmë, QKR-ja është një realitet në zhvillim, duke u shkëputur kështu nga procedurat e zgjatura burokratike gjyqësore dhe duke i shndërruar tërësisht regjistrimet dhe ndryshimet që pëson biznesi, në një procedurë administrative. Institucioni i QKR-së është pjesë e hapësirës europiane. Ne do të vazhdojmë të jemi gjithmonë pranë biznesit me cilësi, shërbim e shpejtësi në njësinë e kohës, sepse ne jemi **“Imazhi udhërrëfyes për biznesin”**



A.1 Struktura organizative dhe buxheti

Qendra Kombëtare e Regjistrimit funksionon sipas strukturës së miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 120, datë 16.10.2012 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit është gjithsej 50 vetë. QKR-ja aktualisht numëron 33 sportele në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në të cilat shërbejnë 75 punonjës.

Të gjitha aplikimet e kryera dhe veprimet që kanë lidhje me bizneset procesohen nga struktura e regjistrimit e vendosur në zyrën qendrore në Tiranë.

Administrata e QKR-së drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm. QKR-ja është e organizuar në drejtori e sektorë.

Drejtori i Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm drejton, organizon, koordinon dhe kontrollon gjithë veprimtarinë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Drejtoria e Regjistrimit

Drejtoria e Regjistrimit është përgjegjëse për regjistrimet në regjistrin tregtar dhe koordinon punën në të gjitha sportelet e QKR-së.

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Regjistrit Elektronik (IT)

Drejtoria e IT-së është përgjegjëse për mirëmbajtjen e sistemeve software të informacionit dhe për mirëmbajtjen e rrjetit kompjuterik.

Spektori i Shërbimeve Mbështetëse

Spektori i Shërbimeve Mbështetëse përgjigjet për të gjitha funksionet administrative të QKR-së e më konkretisht për: funksionin e financës, burimet njerëzore, protokoll-arkivën, si dhe për personelin mbështetës.

Spektori i Udhëheqjes Metodologjike

Siguron aksesin për të lejuar inspektimin e procedurave të regjistrimit, për të kryer shqyrtimin e ankimeve administrative ndaj veprimeve/mosveprimeve të QKR-së në procesin e regjistrimit. Ky spektori përfaqëson institucionin në të gjitha shkallët e gjykimit në rastet kur QKR-ja është palë në një proces gjyqësor, duke hartuar parashtresa, prapësime, rekurse etj.

Buxheti

Për vitin 2014, QKR-ja pati në dispozicion një buxhet në masën 202,000,000 lekë, i cili përbëhet në masën 27% nga transfertat e kushtëzuar për Njësitë Vendore, ndërsa shpenzimet e personelit përbëjnë 31% të totalit të shpenzimeve dhe ato kapitale 19%. Të ardhurat e siguruar nga tarifat e shërbimeve mbulojnë 23% të shpenzimeve.

B. Korniza ligjore dhe funksionet e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

Organizimi, funksionimi dhe procedurat e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit rregullohen nga kuadri ligjor dhe nënligjor si më poshtë:

LEGJISLACIONI	FUNKSIONET
Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar.	Kryen regjistrimin fillestar të subjekteve të përcaktuara në ligj për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe inspektimit të marrëdhënieve të punës.
VKM Nr.503, datë 01.08.2007 “Për miratimin e tarifave për shërbimet funksionale të QKR”.	Kryen regjistrimet e tjera në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat në fuqi.
VKM Nr.505, datë 01.08.2007 “Për miratimin e statutit të QKR”.	Lëshon certifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve të depozituara sipas përcaktimit të ligjit.
VKM Nr.506, datë 01.08.2007 “Për procedurat e regjistrimit dhe publikimit të QKR”.	Publikon të dhënat e regjistrimit të mbajtur, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to.
VKM Nr.537, datë 01.08.2007 “Për rregullat për emrat dhe emërtimet tregtare”.	Informon dhe këshillon të interesuarit për procedurat e regjistrimit.
Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.	QKR-ja nxit praktikat e mira, përgatit e sugjeron forma e standarde për aktet e krijimit të shoqërive tregtare dhe subjekteve të tjera tregtare apo akte të tjera të nevojshme për veprimtarinë tregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
	QKR-ja bashkëpunon me institucionet publike shqiptare, ato të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të fushës.
	QKR-ja administron pasurinë e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
	QKR-ja harton programe dhe merr masa konkrete për modernizimin e vazhdueshëm të sistemit të regjistrimit.

C. Shërbimet që ofron Qendra Kombëtare e Regjistrimit

C.1 Regjistri tregtar dhe regjistrimi

Regjistri tregtar është një bazë të dhënash unike e subjekteve që sipas legjislacionit shqiptar kryejnë veprimtari ekonomike tregtare. Regjistri mbahet në format elektronik. Regjistrimi, përpunimi, ruajtja e të dhënave të njoftuara dhe të depozituara në regjistër kryhen nëpërmjet një sistemi të informatizuar. Regjistri elektronik përmban faktet, aktet dhe informacionet që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen nga subjektet persona fizikë apo juridikë që ushtrojnë aktivitet tregtar sipas ligjit në fuqi. Ky regjistër ka të publikuar të dhënat e paraqitura nga subjektet tregtare.

QKR-ja ruan dhe arkivon aplikimet dhe dokumentet shoqëruese, të paraqitura nga aplikantët në format shkresor. Regjistri përmban:

- » Të dhënat e identifikimit të subjektit, të dhënat për formën e subjektit (nëse është person fizik/juridik etj);
- » Të dhënat që i përkasin themelimit;
- » Të dhënat për vlerën e kapitalit themeltar të nënshkruar, numrin dhe vlerën e aksioneve;
- » Të dhënat për organizimin e subjekteve;
- » Çdo ndryshim në status;
- » Veprimtarinë e subjektit;
- » Vendin e ushtrimit të veprimtarisë;
- » Të dhënat e identifikimit të administratorit në lidhje me përfaqësimin;
- » Të dhëna të tjera të parashikuara me ligj.

C.1.1 Regjistrimi

Aplikimi për regjistrim kryhet elektronikisht nëpërmjet sportelit elektronik (aplikimi online) ose në sportelet e QKR-së në qendër dhe në njësitë e qeverisjes vendore apo të dhomave të tregtisë.

Procedurat e regjistrimit të biznesit kalojnë në dy faza:

FAZA E PARË: Aplikimi për regjistrim.

FAZA E DYTË: Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimmarrja.

FAZA E PARË/ Aplikimi për regjistrim	FAZA E DYTË/Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimarrja
Aplikimet në sportelet pritëse » Paraqitja fizike e aplikantit në çdo sportel shërbimi të QKR-së; » Dokument identifikimi të personit të autorizuar për aplikim; » Plotësimi i formularit të aplikimit sipas llojit të regjistrimit; » Dorëzimi i dokumenteve shoqëruese; » Paraqitja e dokumentit për pagesën e tarifës përkatëse (100 lekë); » Nëpunësi i sportelit ndihmon personin që paraqitet për aplikim për plotësimin e formularit; » Nënshkrimi i formularit të aplikimit nga aplikuesi dhe nëpunësi i sportelit; » Merret pamja elektronike e formularit të aplikimit dhe e dokumenteve shoqëruese; » Nëpunësi i sportelit lëshon konfirmimin nga sistemi informativ sipas formatit të miratuar; » Konfirmimi përmban edhe numrin e aplikimit (çështjes) të dhënë automatikisht nga sistemi i informatizuar (cn);	Aplikimet shqyrtohen nga Sektori i Regjistrimit në QKR Qendër Tiranë » Nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKR-së verifikon identitetin e nënshkruesit; » Nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) verifikon faktin nëse aplikanti është person i autorizuar për të bërë regjistrimin; » Regjistruesi verifikon plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara në formularin e aplikimit, si dhe dokumentet shoqëruese; » Regjistruesi verifikon paraqitjen, në formën e kërkuar, të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat që regjistrohen; » Regjistruesi verifikon faktin nëse të dhënat e shprehura në formularin e regjistrimit nuk kundërshtojnë, në mënyrë të dukshme, të dhënat që përmbajnë dokumentet që shoqërojnë formularin; » Regjistruesi verifikon faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë, është e palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik; » Regjistruesi verifikon nëse emri i zgjedhur mund të regjistrohet; » Regjistruesi verifikon pagesën e tarifës përkatëse për regjistrim; » Regjistruesi verifikon faktin nëse aplikanti ka shlyer sanksionet administrative të dhëna, sipas nenit 74 të këtij ligji (nëse ka);
Aplikimi online » Aplikanti nuk paraqitet fizikisht në sportelet e QKR. » Dokument identifikimi i aplikantit. » Plotësimi i formularit të aplikimit sipas llojit të regjistrimit. » Dërgimi i dokumenteve shoqëruese në QKR. » Sistemi i QKR lëshon konfirmimin përkatës sipas formatit të miratuar. » Konfirmimi përmban edhe numrin e aplikimit (çështjes) dhënë automatikisht nga sistemi i informatizuar (cn).	

C.1.2 Shërbimet funksionale

Qendra Kombëtare e Regjistrimit ofron për publikun 22 shërbime funksionale, por dhe shumë të tjera:

QKR	Shërbimet funksionale që ofrohen për biznesin	Tarifa	Afati kohor
	Verifikimi i mundësisë së regjistrimit të emrit	100	1 ditë
	Rezervimi i emrit	100	1 ditë
	Transferimi i emrit të rezervuar	100	1 ditë
	Regjistrimi fillestar me formular/statut regjistrimi	100	1 ditë
	Regjistrimi fillestar me statut të përgatitur nga palët	100	1 ditë
	Regjistrime të tjera të detyrueshme dhe vullnetare	100	1 ditë
	Regjistrimi me kërkesë të çdo të treti të vendimeve të autoritetit publik <i>(përveç atyre të bëra nga vetë subjekti)</i>	100	1 ditë
	Regjistrime vullnetare	100	1 ditë
	Çregjistrime	100	30 deri në 90 ditë
	Lëshimi i ekstrakteve për një të dhënë të regjistrimit tregtar	100	1 ditë
	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt	100	1 ditë
	Lëshim ekstrakti për gjendjen e subjektit	100	1 ditë
	Lëshimi i kopjes së statutit	100	1 ditë
	Lëshimi i kopjes së bilancit	100	1 ditë
	Lëshimi i kopjes së listës së aksionarëve	100	1 ditë
	Lëshimi i kopjeve të dokumenteve të tjera shoqëruese <i>(vetëm të një dokumenti)</i>	100	1 ditë
	Lëshimi i dublikatës së certifikatës	100	1 ditë
	Lëshimi i të dhënave për adresën e banimit të individëve, të njoftuar në QKR, sipas ligjit.	100	1 ditë
	QKR-ja siguron përgatitjen dhe venien në dispozicion në ambientet e saj të destinuara për pritjen e publikut në qendër, komuna e bashki, në faqen e saj të internetit, broshura informative, si dhe formularë të detajuar dhe informues.	Pa pagesë	1 ditë
	QKR-ja publikon dhe informon të interesuarit për tarifat e miratuara të shërbimeve që ofron.	Pa pagesë	1 ditë
	QKR-ja mund të kryejë edhe funksione të tjera në ndihmë të biznesit të lidhura me funksione të saj që miratohen nga Ministri dhe përfitohen kundrejt pagesës.	100	1 ditë
	Çdo veprim tjetër i parashikuar nga ligji dhe i pa përmendur më sipër	100	1 ditë

C2 Formularët e aplikimit sipas formës ligjore:

Forma, përmbajtja e formularëve dhe dokumenteve shoqëruese në mënyrë të përmblodhur prezantohen si më poshtë:

Formularë aplikimi për regjistrim fillestar:

1. Personi fizik;
2. Shoqëri "Kolektive, Komandite, Me Përgjegjësi të Kufizuar dhe të Thjeshta";
3. Shoqëri Aksionare;
4. Shoqëri Kursim-Kredit;
5. Shoqëri të Bashkëpunimit Reciprok;
6. Degë dhe Zyra të Përfaqësimit të Shoqërive të Huaja;
7. Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor.

Formularë aplikimi për regjistrimin e ndryshimeve në të dhënat e regjistrimit:

1. Person fizik;
2. Shoqëri Kolektive, Komandite, Me Përgjegjësi të Kufizuar dhe të Thjeshta
3. Shoqëri Aksionare;
4. Shoqëri Kursim-Kredit;
5. Shoqëri të Bashkëpunimit Reciprok;
6. Degë ose Zyra të Përfaqësimit të Shoqërive të Huaja;
7. Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor.

Formularë aplikimi për riorganizimin e shoqërive:

1. Njoftimi i projektbashkimit me përthithje me krijimin e një shoqërie të re;
2. Miratimi i bashkimit me përthithje me krijimin e një shoqërie të re;
3. Njoftimi i projektbashkimit me përthithje nga një shoqëri ekzistuese;
4. Miratimi i bashkimit me përthithje nga një shoqëri ekzistuese;
5. Njoftimi i ndarjes (ndarje në favor të shoqërive të themeluara rishtazi);
6. Miratimi i ndarjes;
7. Njoftimi i projekt-ndarjes (ndarje në favor të shoqërive ekzistuese);
8. Miratimi i ndarjes (ndarje në favor të shoqërive ekzistuese);
9. Thirrje të aksionarëve/ortakëve për miratimin e shndërrimit - Shpallja 1;
10. Thirrje të aksionarëve/ortakëve për miratimin e shndërrimit - Shpallja 2;
11. Miratimi i shndërrimit.

Formular aplikimi për çregjistrim

1. Formular aplikimi për fillimin e procedurës së likuidimit;
2. Formular aplikimi për çregjistrim të:
 - a) Personit fizik
 - b) Personit juridik

Formular aplikimi për depozitimin e bilancit

1. Formular aplikimi për depozitimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të auditit.

Formularë të tjerë dhe formatet e kthimit të përgjigjes për çdo veprim të kryer në regjistrin tregtar

1. Ekstrakte (të thjeshta dhe historike) të regjistrit tregtar për çdo subjekt që regjistrohet në regjistrin tregtar;
2. Vërtetim i kryerjes së aplikimit;
3. Vendimi i pezullimit;
4. Vërtetimi i kryerjes së regjistrimit;
5. Format i aplikimit për korrigjim;
6. Formulari i njoftimit të pezullimit;
7. Formulari i refuzimit të regjistrimit;
8. Certifikatë regjistrimi;
9. Certifikatë çregjistrimi;
10. Format i rezervimit të emrit.

C.3 Shërbime të reja për publikun

C.3.1 Aplikimi online

Aplikimi online është procesi i kërkimit dhe aksesimit nga një individ ose subjekt të një shërbimi të ofruar prej QKR-së nëpërmjet portalit unik qeveritar. Subjekti/individ nuk paraqitet fizikisht pranë sporteleve të QKR-së për kryerjen e aplikimit, por mund ta realizojë atë nëpërmjet infrastrukturës së tij/internetit.

Aplikimi online mund të kryhet nga çdo individ/qytetar ose subjekt (i pajisur me NUIS/NIPT), të cilët duhet të regjistrohen fillimisht në portalin unik qeveritar e-albania. Regjistrimi në këtë portal bëhet duke plotësuar respektivisht të dhënat e kërkuara në varësi të faktit nëse aplikimi do të kryhet nga një individ apo subjekt.

Të dhënat e kërkuara për regjistrim janë si më poshtë:

- » **Për t'u regjistruar si subjekt:** NUIS (NIPT); fjalëkalimi; e-maili; numri i telefonit; emri i subjektit (biznesit); pyetja e sigurisë; si edhe të dhënat për administratorin e subjektit, të tilla si: emri, mbiemri, emri i babait, datëlindja, numri personal.
- » **Për t'u regjistruar si individ:** Kodi; fjalëkalimi; e-maili; numri i celularit; si dhe të dhënat personale: emri, mbiemri, emri i babait, datëlindja.

Shërbimet që ofrohen nëpërmjet aplikimit online

Individët apo subjektet mund të aplikojnë online për të marrë shërbime të tilla si:

- 1) Regjistrimi fillestar: Shërbimi i regjistrimit fillestar të një subjekti mund t'i ofrohet një individ/qytetari që ka krijuar në portal llogarinë e tij si individ.
- 2) Ndryshime në të dhënat e regjistruara: Shërbimi i ndryshimit të të dhënave të regjistruara mund t'i ofrohet vetëm një subjekti/biznesi që është i regjistruar tashmë në QKR. Aplikimi online për ndryshim është i ngjashëm me procedurën e regjistrimit fillestar.
- 3) Depozitimi i pasqyrave financiare dhe i raporteve të auditit.
- 4) Tërheqja/shkarkimi i ekstrakteve të regjistrimit tregtar, elektronikisht të nënshkurara etj.

C.3.2 Përmirësimi i imazhit të institucionit të QKR-së

Faqja e internet (Userfriendly) është një tjetër shërbim i përmirësuar dhe i riformatuar.

- » Rritja e shpejtësisë së portalit në drejtim të gjenerimit të informacionit, kështu kërkimi i subjekteve, është ulur nga 40 në 5.2 sekonda, me prioritet në të ardhmen shfaqja në kohë reale.
- » Rikonceptimi i mënyrës së shfaqjes së të dhënave dhe përzgjedhja me kujdes e informacionit.
- » Rikonceptimi i seksionit për subjektet e huaja. Sakaq, numri i vizitorëve nga jashtë vendit është rritur me 66% krahasuar me vitin 2013, duke na dhënë një pamje të qartë se pritshmëria ndaj performancës ekonomike dhe institucioneve që lidhen direkt me to, ka pësuar një ndikim pozitiv tek investitorët e huaj, duke përfshirë edhe ata që operojnë tashmë në tregun vendas.
- » Faqja e internetit tashmë përmban një informacion të përditësuar dhe të përkthyer në gjuhën e huaj, si edhe një manual përdorimi shoqëruar me një video ilustruese.

Theksojmë që falë kësaj ndërhyrjeje të menjëhershme në përmirësimin e sistemit të komunikimit, QKR-ja ka arritur një numër rekord vizitorësh krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me një rritje prej 116% krahasuar me 2013.

C.3.3 Buletini i njoftimeve zyrtare

Në drejtim të përmirësimit dhe lehtësimit të regjistrimit të biznesit, por dhe marrjes në kohë reale të informacionit, duke filluar nga muaji dhjetor 2013, në portalin e QKR-së është publikuar Buletini i Njoftimeve Zyrtare, i cili gjeneron në kohë reale çdo të dhënë të regjistruar në regjistrin tregtar nga QKR-ja.

C.3.4 Kontrolli i statusit të aplikimit për regjistrim

Është një shërbim i ri që ofrohet tashmë online nëpërmjet portalit të QKR-së. Statusi i regjistrimit, si dhe arsyet e pezullimit apo refuzimit të një aplikimi, mund të kontrollohen lehtësisht, pa qenë nevoja për t'u prezantuar në sportele.

C.3.5 Nënshkrimi elektronik

Duke filluar nga data 22 prill 2014, Qendra Kombëtare e Regjistrimit ka siguruar ofrimin e shërbimit të lëshimit të ekstrakteve (të thjeshtë dhe historikë) elektronikisht të nënshkruara. Po gjatë kësaj periudhe u realizua për herë të parë nënshkrimi elektronik, pra QKR-ja u bë

institucioni i parë publik që ka testuar këtë shërbim, duke i hapur rrugën një ere të re komuni-
kimi virtual midis institucioneve dhe biznesit. Gjatë vitit 2014 janë dhënë mbi 1,800 certifikata
çregjistrimi dhe 1,548 ekstrakte të nënshkuara elektronikisht.

C.3.6 Kërko për emër të lirë

Është një shërbim tjetër i ri që ofrohet nga QKR-ja. Çdo individ, nëpërmjet aksesimit online
të portalit, mund të kërkojë për emër të lirë përpara regjistrimit të tij në QKR. Gjithashtu, duke
paguar tarifën përkatëse të aplikimit, ka të drejtë të rezervojë pranë regjistrarit tregtar, për llogari
të tij apo të të tretëve, një apo më shumë emra të caktuar për regjistrim.

C.3.7 Paketë informuese për regjistrimin e bizneseve të huaja

Ofrimi i informacionit në gjuhë të huaj si dhe përgatitja e një pakete të plotë në gjuhën angleze
për regjistrimin e bizneseve të huaja, kanë sjellë lehtësim në aksesimin e të dhënave të regjis-
trit dhe njohjen me procedurat e regjistrimit për shtetasit dhe investitorët e huaj. Gjithashtu,
informacioni në faqen zyrtare të internetit është përkthyer në gjuhën angleze.

D. Aneksi i statistikave

Tabela Nr. 1 Shërbimet për biznesin

Qëllimi i vizitës	Nr. apl/2012	Nr. apl/2013	Nr. apl/2014	Ndryshimi 13/14
Regjistrim	26,025	22,859	31,180	39.7
Bilanci vjetor	16,267	16,334	21,988	34.6
Ekstrakt	96,915	100,429	130,035	29.5
Ekstrakt i nënshkuar elektronikisht	-	-	1548	100.0
Fillim i Procedurës së Likuidimit	593	444	440	-0.9
Korrigjim	3,877	1,251	1,018	-18.6
Miratimi i Bashkimit /I ndarjes	53	43	37	-14.0
Ndryshim	24,824	23,095	33,965	47.1
Pezullim Aktiviteti	5,373	5,020	6,001	19.5
Aktivizim i Aktivitetit të Pezulluar	1,773	1,997	2,610	30.7
Plotësim Ekstrakti Historik	1,702	6,311	6,277	-0.5
Printo Certifikatë	2,170	2,396	3,116	30.1
Projekt-Bashkimi me Përthithje	68	45	45	0.0
Projekt-Ndarje	3	6	4	-33.3
Shndërrimi i Shoqërisë	46	18	18	0.0
Shpallja I/II	98	22	32	45.5
Transferim Emri	2	1	1	0.0
Rezervim Emri	130	113	197	74.3
Totali	179,919	180,384	238,512	32.6

Grafikisht




Tabela Nr. 2. Regjistrimet e reja sipas qarkut dhe qyteteve

REGJISTRIMET E REJA							
Periudha			Ndryshimi në %	Rrethi	Periudha		
Qarku	2013	2014			2013	2014	Ndryshimi në %
Berat	344	590	171.5	Berat	253	444	75.5
				Kuçovë	59	105	78.0
				Skrapar	32	41	28.1
Diber	169	252	149.1	Bulqizë	42	66	57.1
				Dibër	52	125	140.4
				Mat	75	61	-18.7
Durrës	1067	1861	174.4	Durrës	909	1632	79.5
				Krujë	158	229	44.9
Elbasan	687	941	137.0	Elbasan	531	709	33.5
				Gramsh	30	47	56.7
				Librazhd	78	122	56.4
				Peqin	48	63	31.3
Fier	854	1132	132.6	Fier	506	715	41.3
				Lushnje	304	361	18.8
				Mallakastër	44	56	27.3
Gjirokaster	230	380	165.2	Gjirokastër	130	243	86.9
				Përmet	54	83	53.7
				Tepelenë	46	54	17.4
Korçe	570	942	165.3	Devoll	48	99	106.3
				Kolonjë	42	48	14.3
				Korçë	332	564	69.9
				Pogradec	148	231	56.1
Kukes	109	255	233.9	Has	21	35	66.7
				Kukës	59	154	161.0
				Tropojë	29	66	127.6
Lezhe	335	660	197.0	Laç	73	170	132.9
				Lezhë	222	429	93.2
				Mirditë	40	61	52.5
Shkoder	530	1228	231.7	Malësi e Madhe	46	109	137.0
				Pukë	46	49	6.5
				Shkodër	438	1070	144.3
Tirane	6001	7000	116.6	Kavajë	244	339	38.9
				Tiranë	5757	6661	15.7
Vlore	1055	1490	141.2	Delvinë	16	61	281.3
				Sarandë	297	458	54.2
				Vlorë	742	971	30.9
Totali					11,951	16,731	40.0

Grafikisht: Sipas qarkut




Tabela Nr. 3 Regjistrimet e reja sipas kombësisë

Pronësia	Viti 2013	Viti 2014	Ndryshimi në %
Shqiptare (100%)	10,928	15,463	41.5
E huaj (100%)	733	948	29.3
Shqiptare-shtetërore	2	2	0.0
E përbashkët (shqiptare - e huaj)	281	318	13.2
Null	7	0	-100.0
Totali	11,951	16,731	40.0

Grafikisht




Tabela Nr. 4 Bizneset sipas formës ligjore

Forma ligjore	Viti 2013	Viti 2014	Krahasimi (%)
Degë e Shoqërisë së Huaj	48	68	42
Person Fizik	9,694	14,285	47
Perfaqësues Tatimor	7	-	(100)
Shoqëri Aksionare	50	40	(20)
Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor	19	38	100
Shoqëri e Bashkëpunimit Reciprok	1	1	-
Shoqëri e Thjeshtë	-	2	1
Shoqëri Kursim-Krediti	4	3	(25)
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	2,111	2,279	8
Zyrë Përfaqësimi e Shoqërisë së Huaj	17	15	(12)
Totali	11,951	16,731	40

Grafikisht




Tabela Nr. 5 Biznese të reja sipas gjinisë së ortakëve apo administratorit

Viti	Regjistrime e reja	Administratore Femra	Pronesi te femrave	Totali Femra	Totali Meshkuj	Perqindja Femra	Perqindja Meshkuj
2013	11,951	439	968	1,407	10,544	11.8%	88.2%
2014	16,731	427	1,520	1,947	14,784	11.6%	88.4%

Grafikisht




Tabela Nr. 6 Numri i vizitorëve në portalin www.qkr.gov.al



OKR porta e regjistrimit të biznesit tuaj.

Oraret e punës
për publikun në
sportelet e QKR:

Çdo ditë nga
e Hëna në të Enjte

ora **8⁰⁰ - 14⁰⁰**

Të premten ora:

ora **8⁰⁰ - 13⁰⁰**

Për të marrë përgjigje për çdo paqartësi apo
informacion më të detajuar mund të:

Vizitoni faqen e internetit të QKR: **www.qkr.gov.al**

Telefononi në numrin e telefonit: **042250066**

Shkruani në adresën e e-mailit: **info.qkr@qkr.gov.al**

Vizitoni sportelet e QKR-së.

Ky botim u mundësua nga:



**Raiffeisen
BANK**

Fitoni çdo sfidë